

AQUATIQ SHPK

**PASQYRAT FINANCIARE ME DHE PER
VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2018**

PERMBAJTJA**FAQJA**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	4
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL NETO	6
SHENIMET SHPJEGUESE	7 - 17

Aquatiq shpk

Pasqyra e pozicionit financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
(shumat ne Lek)

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,337	47,841
Te drejta te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit	5	5,381,758	4,332,795
Te tjera te arketueshme	6	1,834,185	731,653
Kapital i nenshkruar i papaguar		6,850,500	6,850,500
Shpenzime te shtyra	7	12,875	2,250
Aktive afatshkurtra totale		14,080,655	11,965,039
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	1,995,230	1,493,121
Aktive tatimore te shtyra	9	2,301,633	-
Aktive afatgjata totale		4,296,863	1,493,121
AKTIVE TOTALE		18,377,518	13,458,160
DETYRIME DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	10	6,434,310	4,784,858
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore		592,681	6,696
Te pagueshme per detyrimet tatimore	11	66,860	-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	12	56,943	-
Provizione	13	10,800	15,000
Detyrime afatshkurtra totale		7,161,594	4,806,554
Detyrime afatgjata			
Titujt e huamarrjes	14	28,061,024	13,315,000
Detyrime afatgjata totale		28,061,024	13,315,000
DETYRIME TOTALE		35,222,618	18,121,554
Kapitali dhe rezervat		6,850,500	6,850,500
Humbje te akumuluar		(11,513,894)	-
Humbja e vitit		(12,181,706)	(11,513,894)
Kapitali dhe rezerva totale		(16,845,100)	(4,663,394)
DETYRIME DHE KAPITALI TOTALE		18,377,518	13,458,160

Keto pasqyra jane miratuar dhe nenshkruar nga perfaqesuesi ligjor i shoqerise Aquatiq me 29.03.2019.

Perfaqesuesi ligjor
Endlers Kertusha

Endlers Kertusha

AQUATIQ Sh.p.k
"Elëkonit" Pallati Nr1 poshtë
Fakultetit Gjeologjik
Tiranë 1000, Albania
L71320011G

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faja 1 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		-	-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Shpenzime te personelit		(2,142,929)	(74,131)
<i>Paga dhe shperblime</i>		<i>(1,919,759)</i>	<i>(29,759)</i>
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore</i>		<i>(223,170)</i>	<i>(44,372)</i>
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(344,268)	-
Shpenzime te tjera shfrytezimi	15	(13,588,010)	(11,505,176)
Te ardhura/(shpenzime) financiare	16	1,591,868	65,413
<i>Te ardhura/(shpenzime) nga interesi</i>		<i>88</i>	<i>-</i>
<i>Fitim (humbje) nga kurset e kembimit</i>		<i>1,576,780</i>	<i>65,413</i>
<i>Te ardhura/(shpenzime) te tjera financiare</i>		<i>15,000</i>	<i>-</i>
Humbja para tatimit	17	(14,483,339)	(11,513,894)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
<i>Shpenzimi i tatim fitimit te shtyre</i>		<i>2,301,633</i>	<i>-</i>
Humbja e vitit		(12,181,706)	(11,513,894)
Te ardhura te tjera gjithepershires per vitin		-	-
Totali i humbjeve gjithepershires per vitin		(12,181,706)	(11,513,894)

Pasqyra e performances dhe te ardhurave te tjera gjithepershires duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytezimit			
Humbja e vitit	17	(12.181.706)	(11.513.894)
Rregullimet per shpenzimet/ te ardhurat jomonetare:			
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>	15	1.591.868	65.413
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin e shtyre</i>	9	(2.301.633)	-
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:			
<i>Rritje/(renie) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera</i>	5, 6	(2.151.494)	(5.064.448)
<i>Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme</i>	9	1.649.450	4.784.858
<i>Rritje/(renie) per detyrimet tatimore</i>	10	66.860	-
<i>Rritje/(renie) ne detyrime per punonjesit</i>		585.985	6.696
<i>Rritje/(rënie) për shpenzime të konstatuara</i>	11	56.943	-
<i>Rritje/(renie) per shpenzime te shtyra</i>	7	(10.624)	(2.250)
<i>Rritje/(renie) ne provizione</i>	13	(4.200)	15.000
Mjete monetare nga aktiviteti i shfrytezimit		(12,698,551)	(11,708,624)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i investimit			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	8	502.109	1.493.121
Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit		502,109	1,493,121
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit			
Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
Hua te arketuara	14	14.746.024	13.315.000
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit		14,746,024	13,315,000
Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare		1,545,364	113,254
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 1 janar 2018	4	47,841	-
Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare	16	(1.591.868)	(65.413)
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 31 dhjetor 2018	4	1,337	47,841

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 18. te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	Kapitali i nenshkruar	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar me 20 janar 2017	6,850,500	-	6,850,500
Humbja e vitit	-	(11,513,894)	(11,513,894)
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2017	6,850,500	(11,513,894)	(4,663,394)
Pozicioni financiar me 1 janar 2018	6,850,500	(11,513,894)	(4,663,394)
Humbja e vitit	-	(12,181,706)	(12,181,706)
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2018	6,850,500	(23,695,600)	(16,845,100)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital neto duhet duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

1. Informacion i pergjithshem mbi shoqerine

Aquatiq shpk (ne vijimesi referuar si "Shoqeria"), eshte regjistruar me 20 janar 2017 prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NIPT L71320011G. Veprimtaria e Shoqerise rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit "Per Shoqerite tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aquatiq eshte nje shoqeri shqiptare e zoteruar teresisht nga Z. Endlers Kertusha, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i Shoqerise.

Selia e Shoqerise ndodhet prane Rruga Sheh Ahmet Pazari, Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap.Nr.30, Tirane.

Aktiviteti kryesor e kesaj Shoqerie eshte akuaponia, nje sistem qe kombinon akuakulturen konvencionale (rritjen e kafsheve ujore te tilla si kermij, peshq, karavidhe ose karkaleca deti ne rezervuare) me hydroponine (kultivimin e bimeve ne uje) ne nje mjedis simbiotik.

Komiteti i Investimeve Strategjike miratoi dhe i jep Shoqerise nepermjet vendimit me nr. 4/4, date 19.04.2018, statusin e "Investimit/Investitorit Strategjik", duke qene se ka permbushur kriteret e parashikuara ne legjislacion per investimet strategjike ku parashikohet nje vlere investimi prej 5.100.000 (pese million e njeqind mije) Euro.

Me 31 dhjetor 2018 Shoqeria ka deklaruar vetem perfaqesuesin ligjor ne listepagesen e saj.

2. Bazat e pergatitjes

2.1 Deklarata e pajtuesmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (SKK) dhe Ligjin nr.9228, date 29 prill 2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat Financiare te Shoqerise pergatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe menaxhimi i Shoqerise te kryeje vleresime dhe supozime qe ndikojne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel.

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerine per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Manaxhimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen. Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale. Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte:

2. Bazat e pergatitjes (vazhdim)**2.5 Vleresime dhe gjykime (vazhdim)***Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme*

Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pamundesia per te paguar detyrimet. Keto vleresime bazohen ne moshen e te drejtave te arketueshme dhe eksperienca e meparshme ne cregjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojte per zhvleresim te tyre.

Provizionet

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e ceshtjeve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te detyrimit aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%. Ne te tilla raste shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatin e ceshtjes. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojte per krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2018 eshte detajuar si me poshte:

Kurset e kembimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare perbehen nga mjetet monetare, nje instrument borxhi (si llogari, deftese ose hua e arketueshme ose e pagueshme) qe plotesojne kushtet, hua te marra ose te dhena dhe detyrime financiare. Instrumentat financiare njihen fillimisht me kosto plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Kostoja eshte (a) vlere e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlere e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlere e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Aktivitet financiare cregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivitet financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivitet. Detyrimet financiare cregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

3. Politikat kontabel (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Aktivet monetare

Aktivet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Te drejta e arketueshme

Te drejta e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejta e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transaksioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivitet dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

3.3 Inventaret

Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te vogel mes koston dhe cmimit te realizuar te shitjes i zvogeluar me shpenzimet e ndryshueshme te shitjes. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vlere te inventareve deri ne cmimin e realizuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitet ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kosto cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivitet. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitet kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktivitet afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabel (vazhdim)**3.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitetit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit.

Jetegjatesia e vleresuar per vitin aktual eshte si me poshte:

Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Toka	Nuk amortizohet	-
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlere e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlere e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Vlere e mbetur	25%
Instrumenta dhe vegla pune	Vlere e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

iv. C'registrimi

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Fitimi dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren paraysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

3.5 Te ardhurat

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme dhe se ne vleresimin e vleres se drejte merren ne konsiderate edhe zbritjet e mundshme qe i behen emimit te transaksionit.

3.6 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit perfitoen jashte rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike, duke perfshire fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet ne llogarite/kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per t'u paguar furnitorëve (nese rezulton nje humbje neto, ajo njihet ne zerin "Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit").

3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

3.8 Shpenzime te personelit*Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Qeveria Shqiptare jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabel (vazhdim)

3.8 Shpenzime te personelit (vazhdim)

Shoqeria ka deklaruar, perlogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore", si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, mesatarisht per 1 punonjes gjate vitit 2018.

3.9 Tatim fitimi

Shpenzimi i tatim fitimit perfaqeson shumen e detyrimit tatimor dhe tatimet te shtyre.

Tatim fitimi i vitit

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin ne fuqi per "Tatimin mbi fitimin". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjitha barren per vitin korrent. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin financiar 2018 eshte 15 % (2017: 15%).

Tatimi i shtyre

Tatimi i shtyre njihet si diferenca e perkohshme ndermet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar ne bazen tatimore.

Detyrimet e tatimit te shtyre ne pergjithesi llogariten per te gjitha diferencat e tatueshme te perkohshme. Aktivet e tatimit te shtyre ne pergjithesi njihen per te gjitha diferencat e zbritshme te perkohshme ne masen qe ekziston mundesia qe fitimi i tatueshem do te jete i mundshem ne menyre qe keto diferenca te zbritshme te perkohshme te mund te perdoren. Keto aktive dhe detyrime te tatimit te shtyre nuk do te njihen ne qofte se keto diferenca rezultojne nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve ne nje transakcion qe nuk prek as fitimin e tatueshem, as fitimin kontabel. Vlera kontabel e aktiveve dhe detyrimeve te tatimit te shtyre rishikohet ne fund te cdo periudhe raportuese dhe reduktohet ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te arrihet nje fitim i tatueshem i mjaftueshem qe te lejoje qe nje pjese ose i gjithe aktiviteti te rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e tatimit te shtyre maten ne normen e tatimit qe pritet te perdoret ne periudhen ne te cilen detyrimi ka ndodhur ose aktiviteti eshte realizuar, bazuar ne normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal qe ka qene ne fuqi ose ka hyre ne fuqi ne fund te periudhes se raportimit.

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyre i vitit

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyre i vitit njihen ne pasqyren e performances, pervecse kur lidhen me zera qe njihen ne te ardhura te tjera permbledhese ose drejtperdrejte ne kapital, rast ne te cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyre njihen gjithasthu ne te ardhura te tjera permbledhese ose drejtperdrejte ne pasqyren e kapitalit perkatesisht.

3.4 Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura percaktohen kur nje pale kontrollohet nga pala tjetere ose ka ndikim te rendesishem ne vendimet e biznesit apo vendimet financiare te pales tjetere. Per qellime te pasqyrave financiare, drejtimi i shoqerise dhe manaxhimi konsiderohen si pale te lidhura.

3.5 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje ne te ardhmen flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimet ne fjale. Provizionet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parash per shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.6 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per aq kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Nje aktiv i kushtezuar nuk paraqitet ne pasqyrat financiare, por paraqitet ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Banka ne monedhen e huaj	979	43.983
Banka ne monedhen vendase	358	3.859
Totali	<u>1,337</u>	<u>47,841</u>

5. Te drejta te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit

Te drejta dhe detyrime nga ortaku me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Te drejta te arketueshme nga ortaku (ne valute)	6,143,714	4,280,024
Detyrime ndaj ortakut (ne monedhen vendase)	(761,956)	52,771
Totali	<u>5,381,758</u>	<u>4,332,795</u>

6. Te tjera te arketueshme

Te drejta te tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e kreditueshme	1,612,029	731,653
Parapagim per qerane e zyres	222,156	-
Totali	<u>1,834,185</u>	<u>731,653</u>

7. Shpenzime te shtyra

Shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime per garanci projekti	9,972	-
Sherbime ruajtje dhe sigurie	2,903	-
Shpenzime website	-	2,250
Totali	<u>12,875</u>	<u>2,250</u>

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

Pershkrimi	Impiante dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Totali
Kosto			
Pozicioni me 20 janar 2017	-	-	-
Shtesa gjate vitit 2017	791.611	701.510	1,493,121
Pakesime gjate vitit 2017	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2017	791,611	701,510	1,493,121
Shtesa gjate vitit 2018	78.150	768.227	846,377
Pakesime gjate vitit 2018	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2018	869,761	1,469,737	2,339,498
Amortizimi i akumuluar	-	-	-
Pozicioni me 20 janar 2017	-	-	-
Shtesa gjate vitit 2017	-	-	-
Pakesime gjate vitit 2017	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2017	-	-	-
Shtesa gjate vitit 2018	(53,775)	(290,493)	(344,268)
Pakesime gjate vitit 2018	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2018	(53,775)	(290,493)	(344,268)
Vlere kontabel neto me 1 janar 2018	791,611	701,510	1,493,121
Vlere kontabel neto me 31 dhjetor 2018	815,986	1,179,244	1,995,230

9. Aktive tatimore te shtyra

Aktive tatimore te shtyra me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	2018
Me 01.01.2018	2,557,370
Njohur ne pasqyren e performances	(255,737)
Me 31.12.2018	2,301,633

Ne perpurthje me SKK 15, shpenzimet e nisjet se aktivitetit njihe si shpenzim periudhe. Sipas ligjit te tatimit mbi te ardhurat, keto shpenzime do te njihen si shpenzime te zbritshme per efekt llogaritje te tatimit mbi fitimin duke amortizuar me nje norme prej 15% ne vit. Ky aktiv pakesohet cdo vit per vleren 15% te shpenzimeve te amortizimit te njohura sipas ligjit te tatimit mbi te ardhurat duke renduar shpenzimet per tatimin e shtyre te atij viti.

10. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Creatics	2,299.348	3.449.610
ECF Farmsystems GmbH	1.851.300	-
Deloitte Albania shpk	725.710	845.562
Rubikon	543.008	-
Deloitte Legal shpk	444.313	159.541
Alba Skela Construction shpk	370.260	-
Jona Travel & Tours	139.058	-
Vodafone sh.a	48.423	24.573
Acrem shpk	12.890	-
Dritan Husabelliu	-	302.640
Alba Elettrica	-	2.933
Totali	<u>6,434,310</u>	<u>4,784,858</u>

11. Te pagueshme per detyrimet tatimore

Te pagueshme tatimore me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatim mbi te ardhurat personale	56.864	-
Tatimi ne burim	9.996	-
Totali	<u>66,860</u>	<u>-</u>

12. Te pagueshme per shpenzime te konstatuara

Te pagueshme per shpenzime te konstatuara me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime telefonie	19,917	-
Shpenzime qeraje (15 dhjetor -31 dhejtor 2018)	37,026	-
Totali	<u>56,943</u>	<u>-</u>

13. Titujt e huamarrjes

Titujt e huamarrjes deri me 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua ndaj G.P.G Company shpk (ne valute)	24.684.000	6.647.500
Hua ndaj Isa Kertusha (ne valute)	3.357.024	6.647.500
Hua ndaj Isa Kertusha (ne monedhen vendase)	20.000	20.000
Totali	<u>28,061,024</u>	<u>13,315,000</u>

14. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Nga data themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Konsulence manaxheriale	6.702.238	670.068
Sherbime ligjore	1.277.216	536.092
Shpenzime udhetimi	1.244.828	2.261.793
Studime fizibiliteti	1.100.140	601.605
Qira zyre	641.508	-
Sherbime kontabiliteti	563.601	441.705
Studim marketingu per hyrje ne treg	560.079	5.252.121
Shpenzime telefonie	303.353	178.992
Studime mjedisore	290.246	334.025
Shpenzime te tjera	229.504	32.395
Sigurim aktiviteti	109.684	-
Sherbime sekretariati	105.164	362.846
Taksa dhe tarifa vendore	101.000	101.000
Shpenzime per zyren	75.170	-
Kuote anetaresimi	64.965	-
Shpenzime per sherbimet bankare	62.197	40.714
Sherbim ruajtje dhe sigurie	51.097	-
Publicitet, reklama	25.974	-
Blerje te pastokueshme	22.765	66.378
Shpenzime web	18.082	11.251
Gjoha dhe penalitete	15.266	276.922
Shpenzime kancelarike	12.400	36.627
Shpenzime mobilimi	8.333	-
Shpenzime noterie	3.200	-
Shpenzime akomodimi	-	200.640
Shpenzime dizeno dhe interiori per zyren	-	100.000
Totali	13,588,010	11,505,176

15. Te ardhura te tjera financiare

Te ardhura te tjera financiare per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Nga data themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	96.313	126.796
Fitim nga kembimet valutore	(1.673.093)	(192.108)
Te ardhura nga interesat	(90)	(101)
Shpenzime nga interesat	2	-
Te ardhura/(shpenzime) te tjera financiare	(15.000)	-
Totali	(1,591,868)	(65,413)

16. Shpenzime te tatimit mbi fitimin

Shpenzime te tatimit mbi fitimin per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Nga data themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Humbja para tatimit	(14,483,339)	(11,513,894)
Te ardhura te patatueshme	(15,000)	-
Shpenzime te panjohura	1,591,394	2,771,750
Shpenzime tatimore - amortizimi i shpenzimeve te nisjes se aktivitetit	(1,704,913)	-
Humbja e vitit	(14,611,858)	(8,742,144)
Humbje fiskale e mbartur	(8,742,144)	-
Humbja e periudhes	(23,354,002)	(8,742,144)
Shpenzim tatim fitimi (15% per 2018)	-	-
Tatim fitimi i parapaguar	-	-
Tatim fitimi per tu paguar\brenda 1 prill 2019	-	-
Tatimi mbi fitimin	-	-
Shpenzimi per tatim fitimin e shtyre	2,301,633	-

Sipas legjislacionit fiskal shqiptar, norma e aplikueshme e tatim fitimit per vitin 2018 eshte 15%.

Shpenzimet tatimore - amortizimi i shpenzimeve te nisjes

Shoqeria ka kryer nje sere shpenzimet te cilat konsiderohen shpenzime te nisjes dhe zgjerimit te akitvitetit sipas SKK 15 dhe paraqiten si shpenzime te periudhes ushtrimore. Ne baze te legjislacioni tatimor, shpenzimet e nisjes dhe zgjerimit konsiderohen aktive – jo material dhe amortizohen me norme 15%. Ne menyre qe shpenzimet e ushtrimit, te paraqiten ne perputhje me SKK-te dhe shpenzimet tatimore te paraqiten ne perputhje me ligjin e tatimet mbi te ardhurat, shuma e amortizimit vjetor do ti shtohet shpenzimit te ushtrimit per llogarit te shpenzimeve tatimore.

17. Menaxhimi i rrezikut finanicar

Ky shenim permban informacion per ekspozimin e Shoqerise ndaj rrezikut te kredise, rrezikut te likuiditetit dhe rrezikut te tregut. Rreziku i tregut perfshin rrezikun e normes se interesit dhe rrezikun e kurseve te kembimit.

(i) Rreziku i kredise

Ekspozimi i llogarive te arketueshme ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte i lidhur me se shumti me faktin qe Shoqeria ende nuk ka filluar te gjeneroje te ardhura.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson nivelin maksimal te ekspozimit ndaj rrezikut te kredise. Niveli maksimal i ekspozimit ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari te arketueshme	5,381,757	4,332,795
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	1,337	47,841
Aktive tatimore	1,834,185	731,653
Gjendja me 31 dhjetor	7,217,279	5,112,289

Drejtimi ka pergjegjesi per ngritjen dhe kontrollin e nje plani te pergjithshem per manaxhimin e rrezikut. Menaxhimi i rrezikut eshte njeh element thelbësor në aktivitetet e kompanisë. Rreziqet më të mëdha me të cilat kompania përballlet janë ato që lidhen me rrezikun e tregut (duke përfshirë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e monedhës), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit.

(ii) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne çmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e kembimit do te ndikojne ne te ardhurat apo ne vleren e instrumenteve financiare te Shoqerise. Objektivi i manaxhimit te rrezikut te tregut eshte

Aquatiq shpk

Shenimet shpjeguese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018

(shumat ne Lek)

manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem duke optimizuar kthimin.

(iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe Shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Rreziku i likuiditetit eshte rrezik i rendesishem ne biznesin e Shoqerise pasi disa aktive te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Shoqeria manaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhet me profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

	deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
Llogari te arketueshme dhe aktive te tjera	-	7,215,942	-	7,215,942
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	1,337	-	-	1,337
	1,337	7,215,942	-	7,216,279
Llogari te pagueshme dhe te tjera	(7,093,850)	-	-	(7,093,850)
Hua	-	-	(28,061,024)	(28,061,024)
	(7,093,850)	-	(28,061,024)	(35,154,874)
Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2018	(7,092,513)	7,215,942	(28,061,024)	(27,937,595)

(iv) Rreziku i kursit të këmbimit

Kompania mban aktivet dhe detyrimet të shprehura në euro. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më pak ose më shumë se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të kursit të këmbimit të kompanisë është i kufizuar pasi transaksionet në monedhat lekë dhe euro janë të kufizuara.

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2018	Euro	Lek	Totali
Mjete monetare	979	359	1,337
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	8,618,604	(3,236,847)	5,381,757
Aktive të tjera	-	1,834,185	1,834,185
Totali i aktiveve financiare	8,619,583	(1,402,303)	7,217,279
Më 31 dhjetor 2018	Euro	Lek	Totali
Llogari të pagueshme tregtare	(6,233,938)	(200,370)	(6,434,308)
Detyrime të tjera	-	(651,541)	(651,541)
Hua	(28,041,024)	(20,000)	(28,061,024)
Totali i detyrimeve financiare	(34,274,962)	(871,911)	(35,146,873)
Pozicioni neto i kursit të këmbimit	(25,655,379)	(2,274,214)	(27,929,594)

18. Ngjarje pas dates se raportimit

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.